

**Rigers Bakiu** (1982– ) Profesor i asociuar pranë departamentit të akuakulturës dhe peshkimit, i emëruar në pozicionin e përgjegjësit të grupit kërkimor dhe mësimor nga viti 2014. Gjithashtu në vitin 2016 ka qenë edhe përgjegjësi i marrëdhënieve me jashtë në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Ka kryer shkollën tetëvjeçare (shkolla “22 Tetori”, 1997) dhe të mesme (gjimnazi “Babë Dudë Karbunara”, 2000) me mesatare 10 në Berat. Në vitin 2004 është diplomuar në *biologji molekulare* pranë Universitetit të Padovës (Itali), ku edhe kreu studimet e masterit shkencor për biologji molekulare, mbas diplomimit. Gjatë periudhës 2007–2010 ka kryer studimet dhe ka mbrojtur PhD në shkencat biologjike, Universiteti i Padovës, Itali. Nga viti 2010 deri në vitin 2012 ka kryer studimet postdoktorale në shkencat biologjike në Universitetin e Padovës. Mban titullin "Profesor i asociuar", nga viti 2015 dhe zhvillon mësim në disa module: “Hyrje në akuakulturë”, “Inxhinieri e akuakulturës”, “Toksikologji e mjediseve ujore” dhe “Teknikat e prodhimit në marikulturë”. Aktiviteti i kërkimit shkencor lidhet me studime në akuakulturën detare, bioteknologjitë e akuakulturës, peshkimin artizanal dhe studime në sistemet biologjike ujore lidhur me aspektet e toksikologjisë molekulare.

Në të njëjtën kohë pasioni i tij mbetet studimi i evolucionit molekular të proteinave/gjeneve në sisteme të ndryshme biologjike. Ai ka marrë pjesë në më shumë se 10 konferenca shkencore, është autor i teksteve universitare dhe ka publikuar më shumë se 27 artikuj shkencorë, ku 10 prej tyre janë me faktor impakti. Gjithashtu, ka marrë pjesë dhe ka drejtuar projekte ndërkombëtare, si dhe ka zhvilluar ekspertiza në fushën e akuakulturës dhe peshkimit.

Në prill të 2017 fitoi çmimin kombëtar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, si “Shkencëtari i ri më i suksesshëm” dhe aktualisht është kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike në Akademinë e të Rinjve.

Përveç karrierës universitare, të lidhur ngushtë me kërkimin shkencor, Rigers Bakiu ka implementuar dhe vazhdon të jetë lider projektesh të ndryshme të financuara nga organizata ndërkombëtare (MedPAN) apo fondacione të huaja (si: *Save Our Seas Foundation* dhe *Mohammed Bin Zayed* etj.) në mbrojtje të biodiversitetit detar (fokës murgeshë dhe peshkaqenëve) dhe në zhvillim të peshkimit të përgjegjshëm në Shqipëri.